

**RAPORTI I KËNAQSHMËRISË SË  
KONSUMATORËVE TË  
K.R.U. "PRISHTINA" SH.A., PËR VITIN 2024**

Mars, 2025



## OPERATORI EKONOMIK:



### **D&D BUSINESS SUPPORT CENTER**

Rr. "Xheladin Hana", Ndërtesa Iliria,

10000 Prishtina, Republika e Kosovës

Tel.: +383 (0) 38 748 701, +383 (0) 44 693 564

E-mail: [info@dd-bsc.com](mailto:info@dd-bsc.com)

Web: [www.dd-bsc.com](http://www.dd-bsc.com)

## AUTORITETI KONTRAKTUES:



### **K.R.U. "Prishtina" Sh.A**

Rr. "Hazir Shala", nr.4,

10000 Prishtina, Republika e Kosovës

Tel.: +038 (0) 800 90009

E-mail: [info@kru-prishtina.com](mailto:info@kru-prishtina.com)

Web: [www.kru-prishtina.com](http://www.kru-prishtina.com)

## PËRMBAJTJA

1.	HYRJE .....	7
2.	METODOLOGJIA .....	8
3.	TË GJETURAT NGA HULUMTIMI .....	9
3.1.	Lloji i konsumatorit .....	9
4.	KATEGORIA E AMVISËRISË .....	10
4.1.	Zona e Shërbimit.....	10
4.2.	Gjinia.....	11
4.3.	Kënaqshmëria me furnizimin me ujë të pijshëm.....	12
4.4.	Përvoja me defektet teknike (Ujë ose kanalizim).....	13
4.5.	Kënaqshmëria me reagimin dhe efikasitetin e K.R.U. "Prishtina" Sh.A. në rregullimin e defekteve .....	14
4.6.	Vlerësimi për mirësjelljen dhe qasjen e stafit të K.R.U. "Prishtina" Sh.A.....	15
4.7.	Kënaqshmëria mbi efikasitetin e stafit të KRU-së në leximin e ujëmatësve dhe faturimin	16
4.8.	Kënaqshmëria për mundësitë e pagesës së shërbimeve .....	17
4.9.	Kënaqshmëria mbi informimin nga Qendra e thirrjeve në lidhje me shërbimet teknike të kryera	18
4.10.	Pagesa e faturave .....	19
4.11.	Arsyeja e mos pagesës së faturave.....	20
4.12.	Preferenca për metodat e pagesës .....	21
4.13.	Informimi i Konsumatorëve mbi Aplikacionin e K.R.U. "Prishtina" Sh.A.....	22
4.14.	Përdorimi i aplikacionit K.R.U. "Prishtina" Sh.A. ....	23
4.15.	Kënaqshmëria me Përdorimin e Aplikacionit të K.R.U. "Prishtina" Sh.A." .....	24
4.16.	Si informohen konsumatorët për defektet dhe ndërprerjet e ujit.....	25
4.17.	Sa janë të informuar konsumatorët për opsionet e shlyerjes së borxhit.....	26
4.18.	Vlerësimi i konsumatorëve për mundësinë e riprogramimit të borxhit .....	27
4.19.	Ankesa për kompaninë K.R.U. "Prishtina" Sh.A.....	28
4.20.	Kënaqshmëria e konsumatorëve me zgjidhjen e ankesave .....	29
5.	KATEGORIA E BIZNESEVE / INSTITUCIONEVE.....	30
5.1.	Zona e shërbimit.....	30
5.2.	Gjinia.....	31
5.3.	Kënaqshmëria me furnizimin me ujë të pijshëm.....	32
5.4.	Përvoja me defektet teknike (Ujë ose kanalizim).....	33
5.5.	Kënaqshmëria me reagimin dhe efikasitetin e K.R.U. "Prishtina" Sh.A. në rregullimin e defekteve .....	34
5.6.	Vlerësimi për mirësjelljen dhe qasjen e stafit të K.R.U. "Prishtina" Sh.A.....	35
5.7.	Kënaqshmëria mbi efikasitetin e stafit të KRU-së në leximin e ujëmatësve dhe faturimin	36
5.8.	Kënaqshmëria për mundësitë e pagesës së shërbimeve .....	37

5.9.	Kënaqshmëria mbi informimin nga Qendra e thirrjeve në lidhje me shërbimet teknike të kryera	38
5.10.	Pagesa e faturave .....	39
5.11.	Arsyeja e mospagesës së faturave.....	40
5.12.	Preferenca për metodat e pagesës .....	41
5.13.	Informimi i Konsumatorëve mbi Aplikacionin e K.R.U. "Prishtina" Sh.A.....	42
5.14.	Përdorimi i aplikacionit K.R.U. "Prishtina" Sh.A. ....	43
5.15.	Kënaqshmëria me Përdorimin e Aplikacionit të K.R.U. "Prishtina" Sh.A. ....	44
5.16.	Si informohen konsumatorët për defektet dhe ndërprerjet e ujit.....	45
5.17.	Sa janë të informuar konsumatorët për opsionet e shlyerjes së borxhit.....	46
5.18.	Vlerësimi i konsumatorëve për mundësinë e riprogramimit të borxhit .....	47
5.19.	Ankesa për kompaninë K.R.U. "Prishtina" Sh.A.....	48
5.20.	Kënaqshmëria e konsumatorëve me zgjidhjen e ankesave .....	49
6.	REKOMANDIME DHE KONKLUSIONE.....	50
7.	ANEX 1. PYETËSORI.....	51

## Lista e Tabelave

Tabela 1. Lloji i konsumatorit.....	9
Tabela 2. Zona e Shërbimit .....	10
Tabela 3. Gjinia.....	11
Tabela 4. Kënaqshmëria me furnizimin me ujë të pijshëm .....	12
Tabela 5. Përvoja me defektet teknike (Ujë ose kanalizim).....	13
Tabela 6. Kënaqshmëria me reagimin dhe efikasitetin e K.R.U. "Prishtina" Sh.A. në rregullimin e defekteve 14	
Tabela 7. Vlerësimi për mirësjelljen dhe qasjen e stafit të K.R.U. "Prishtina" Sh.A.....	15
Tabela 8. Kënaqshmëria mbi efikasitetin e stafit të KRU-së në leximin e ujëmatësve dhe faturimin..	16
Tabela 9. Kënaqshmëria për mundësitë e pagesës së shërbimeve .....	17
Tabela 10. Kënaqshmëria mbi informimin nga Qendra e thirrjeve në lidhje me shërbimet teknike të kryera .....	18
Tabela 11. Pagesa e faturave .....	19
Tabela 12. Arsyeja e mos pagesës së faturave .....	20
Tabela 13. Preferenca për metodat e pagesës .....	21
Tabela 14. Informimi i Konsumatorëve mbi Aplikacionin e K.R.U. "Prishtina" Sh.A.....	22
Tabela 15. Përdorimi i aplikacionit K.R.U. "Prishtina" Sh.A. ....	23
Tabela 16. Kënaqshmëria me Përdorimin e Aplikacionit të K.R.U. "Prishtina" Sh.A." .....	24
Tabela 17. Si informohen konsumatorët për defektet dhe ndërprerjet e ujit .....	25
Tabela 18. Sa janë të informuar konsumatorët për opsionet e shlyerjes së borxhit.....	26
Tabela 19. Vlerësimi i konsumatorëve për mundësinë e riprogramimit të borxhit .....	27
Tabela 20. Ankesa për kompaninë K.R.U. "Prishtina" Sh.A. ....	28
Tabela 21. Kënaqshmëria e konsumatorëve me zgjidhjen e ankesave .....	29
Tabela 22. Zona e shërbimit.....	30
Tabela 23. Gjinia.....	31
Tabela 24. Kënaqshmëria me furnizimin me ujë të pijshëm .....	32
Tabela 25. Përvoja me defektet teknike (Ujë ose kanalizim).....	33
Tabela 26. Kënaqshmëria me reagimin dhe efikasitetin e K.R.U. "Prishtina" Sh.A. në rregullimin e defekteve .....	34
Tabela 27. Vlerësimi për mirësjelljen dhe qasjen e stafit të K.R.U. "Prishtina" Sh.A. ....	35
Tabela 28. Kënaqshmëria mbi efikasitetin e stafit të KRU-së në leximin e ujëmatësve dhe faturimin	36
Tabela 29. Kënaqshmëria për mundësitë e pagesës së shërbimeve .....	37
Tabela 30. Kënaqshmëria mbi informimin nga Qendra e thirrjeve në lidhje me shërbimet teknike të kryera .....	38
Tabela 31. Pagesa e faturave .....	39
Tabela 32. Arsyeja e mos pagesës së faturave .....	40
Tabela 33. Preferenca për metodat e pagesës .....	41
Tabela 34. Informimi i Konsumatorëve mbi Aplikacionin e K.R.U. "Prishtina" Sh.A.....	42
Tabela 35. Përdorimi i aplikacionit K.R.U. "Prishtina" Sh.A. ....	43
Tabela 36. Kënaqshmëria me Përdorimin e Aplikacionit të K.R.U. "Prishtina" Sh.A. ....	44
Tabela 37. Si informohen konsumatorët për defektet dhe ndërprerjet e ujit .....	45
Tabela 38. Sa janë të informuar konsumatorët për opsionet e shlyerjes së borxhit.....	46
Tabela 39. Vlerësimi i konsumatorëve për mundësinë e riprogramimit të borxhit .....	47
Tabela 40. Ankesa për kompaninë K.R.U. "Prishtina" Sh.A. ....	48
Tabela 41. Kënaqshmëria e konsumatorëve me zgjidhjen e ankesave .....	49

## Lista e Figurave

Figura 1. Lloji i konsumatorit .....	9
Figura 2. Zona e Shërbimit .....	10
Figura 3. Gjinia .....	11
Figura 4. Përvoja me defektet teknike (Ujë ose kanalizim) .....	13
Figura 5. Pagesa e faturave .....	19
Figura 6. Preferenca për metodat e pagesës .....	21
Figura 7. Informimi i Konsumatorëve mbi Aplikacionin e K.R.U. "Prishtina" Sh.A. ....	22
Figura 8. Përdorimi i aplikacionit K.R.U. "Prishtina" Sh.A. ....	23
Figura 9. Si informohen konsumatorët për defektet dhe ndërprerjet e ujit .....	25
Figura 10. Sa janë të informuar konsumatorët për opsionet e shlyerjes së borxhit .....	26
Figura 11. Vlerësimi i konsumatorëve për mundësinë e riprogramimit të borxhit .....	27
Figura 12. Ankesa për kompaninë K.R.U. "Prishtina" Sh.A. ....	28
Figura 13. Zona e shërbimit .....	30
Figura 14. Gjinia .....	31
Figura 15. Përvoja me defektet teknike (Ujë ose kanalizim) .....	33
Figura 16. Pagesa e faturave .....	39
Figura 17. Arsyeja e mospagesës së faturave .....	40
Figura 18. Preferenca për metodat e pagesës .....	41
Figura 19. Informimi i Konsumatorëve mbi Aplikacionin e K.R.U. "Prishtina" Sh.A. ....	42
Figura 20. Përdorimi i aplikacionit K.R.U. "Prishtina" Sh.A. ....	43
Figura 21. Si informohen konsumatorët për defektet dhe ndërprerjet e ujit .....	45
Figura 22. Sa janë të informuar konsumatorët për opsionet e shlyerjes së borxhit .....	46
Figura 23. Ankesa për kompaninë K.R.U. "Prishtina" Sh.A. ....	48

## 1. HYRJE

Kompania D&D Business Support Center, e përzgjedhur nga KRU Prishtina SH .A. në një garë të hapur ëshë përzgjedhur për hulumtimin Matjen e kënaqshmërisë së konsumatorëve dhe ofrimin e informacionit të nevojshëm për përmirësimin e shërbimeve në vitin 2024.

Kompania Rajonale e Ujësjellësit K.R.U. "Prishtina" Sh.A. luan rol kyç në ofrimin e shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit në rajonin e Prishtinës, duke dhënë një angazhim të vazhdueshëm për përmbushjen e kërkesave të larta të konsumatorëve dhe sigurimin e standardeve të cilësisë. Si kompania më e madhe në vend për ofrimin e shërbimeve të ujit dhe kanalizimit, ka mision të qartë për të siguruar furnizimin e qëndrueshëm me ujë të pijshëm dhe trajtimin efikas të ujërave të zeza, . Ky angazhim dhe përkushtim i lartë siguron një proces të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm për përmirësimin e shërbimeve dhe optimizimin e resurseve.

Hulumtimi është realizuar në komunat e regjionit të Prishtinës, përfshirë Prishtinën, Podujevën, Obiliqin, Drenasin, Fushë Kosovën, Lipjanin, Shtimen dhe Graçanicën. Ky raport synon të paraqesë rezultatet e mbledhura nga ky hulumtim dhe të ofrojë një pasqyrë të thelluar mbi kënaqshmërinë e konsumatorëve. Gjithashtu, përmes këtij raporti do të ofrohen rekomandime për përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit të shërbimeve, duke u bazuar në analizat e nevojave dhe problematikave të identifikuar gjatë procesit të matjes së kënaqshmërisë. Rezultatet e këtij studimi do të ndihmojnë K.R.U. "Prishtina" Sh.A. në përcaktimin e prioriteteve dhe strategjive të ardhshme, duke mundësuar një qasje më të saktë dhe të orientuar drejt përmirësimit të vazhdueshëm të shërbimeve për konsumatorët.



## 2. METODOLOGJIA

Për realizimin e këtij hulumtimi është përdorur metodologjia kuantitative, me qëllim të mbledhjes së të dhënave të matshme dhe përfaqësuese mbi nivelin e kënaqshmërisë së konsumatorëve me shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit.

Procesi ka përfshirë disa faza të mirëpërcaktuara, duke filluar me hartimin e një pyetësori të strukturuar, i cili është dizajnuar për të adresuar katër kategori të konsumatorëve: konsumatorët shtëpiakë, biznese të vogla, biznese të mëdha dhe konsumatorë institucionalë. Për secilin grup janë zhvilluar pyetje të përshtatura që fokusohen në përvojat dhe kënaqshmërinë me shërbimet përkatëse.

Mostra është ndarë proporcionalisht sipas shpërndarjes së konsumatorëve në secilën komunë dhe kategori. Janë realizuar gjithsej 4,000 intervista, prej të cilave 3,518 me konsumatorë shtëpiakë dhe 482 me biznese dhe institucione. Kjo ndarje është bërë për të siguruar përfaqësueshmëri të të dhënave në nivel komunal dhe sektorial.

Mbledhja e të dhënave është realizuar në terren përmes intervistave të drejtpërdrejta, duke përdorur platforma elektronike dhe aplikacione të specializuara, të cilat sigurojnë ruajtjen dhe integritetin e të dhënave.

Pas përfundimit të mbledhjes së të dhënave, ato janë analizuar duke përdorur mjete elektronike statistikore, si Excel, për të nxjerrë përfundime të bazuara në krahasime ndërmjet grupeve të konsumatorëve dhe për të identifikuar trendët kryesorë që ndikojnë në kënaqshmërinë e tyre.

Në përfundim, është hartuar një raport analitik, i cili përmban gjetjet kryesore dhe rekomandime konkrete për përmirësimin e shërbimeve. Raporti është formuluar në një gjuhë të qartë dhe të kuptueshme për të mundësuar përdorimin e tij nga autoriteti kontraktor dhe palët e interesuara.



### 3. TË GJETURAT NGA HULUMTIMI


#### 3.1. Lloji i konsumatorit

Tabela dhe grafiku më poshtë pasqyrojnë shpërndarjen e konsumatorëve sipas kategorive dhe komunave të përfshira në studim. Sipas të dhënave, shumica e konsumatorëve të anketuar i përkasin kategorisë së amvisërive që janë 87.95%, ndërsa përqindja më e vogël përfaqësohet nga konsumatorët institucionalë 0.50% dhe 0.85% bizneset e mëdha. Komuna e Prishtinës ka numrin më të lartë të anketuar që është 2,291, duke kontribuar me 57.28% të totalit. Ky rezultat pasqyron popullsinë më të madhe dhe përqendrimin më të lartë të aktiviteteve ekonomike, në këtë zonë. Fushë Kosova dhe Lipjani ndjekin me përqindje përkatësisht 16.33% dhe 7.38%, ndërsa komunat e tjera kanë një pjesëmarrje më të ulët. Në tërësi, grafiku tregon qartë dominimin numerik të konsumatorëve të amvisërisë në të gjitha komunat, me një prani të kufizuar të bizneseve.

Tabela 1. Lloji i konsumatorit

Qytet	Amvisëri	Biznese të vogla	Biznese të mëdha	Konsumatorët Institucional	Totali
Prishtinë	1,967	291	22	11	2,291
	85.86%	12.70%	0.96%	0.48%	57.28%
Fushë Kosovë	603	48	1	1	653
	92.34%	7.35%	0.15%	0.15%	16.33%
Podujevë	261	28	1	2	292
	89.38%	9.59%	0.34%	0.68%	7.30%
Obiliq	129	11	2	1	143
	90.21%	7.69%	1.40%	0.70%	3.58%
Shtime	80	8	1	1	90
	88.89%	8.89%	1.11%	1.11%	2.25%
Drenas	126	19	1	1	147
	85.71%	12.93%	0.68%	0.68%	3.68%
Graçanicë	81	6	1	1	89
	91.01%	6.74%	1.12%	1.12%	2.23%
Lipjan	271	17	5	2	295
	91.86%	5.76%	1.69%	0.68%	7.38%
Total	3,518	428	34	20	4,000
	87.95%	10.70%	0.85%	0.50%	100%

Figura 1. Lloji i konsumatorit



## 4. KATEGORIA E AMVISËRISË

K.R.U. "Prishtina" Sh.A. ofron shërbime të ujësjellësit dhe kanalizimit në tetë komuna, duke përfshirë konsumatorë të ndryshëm nga zonat urbane dhe rurale. Pjesa më e madhe e të anketuarve janë amvisëri, të cilët përbëjnë 87.95% të totalit, ndërsa pjesa tjetër përfshin biznese dhe institucione.


### 4.1. Zona e Shërbimit

Shpërndarja e konsumatorëve të kategorisë së amvisërisë sipas zonave urbane dhe rurale në komunat e përfshira në hulumtim ashtu siç janë paraqitur në tabelën dhe grafën e mëposhtëm duke ofruar një krahasim të qartë midis këtyre dy zonave. Rezultatet tregojnë se 54.24% e konsumatorëve të anketuar jetojnë në zona urbane, ndërsa 45.76% janë nga zonat rurale, duke reflektuar një shpërndarje relativisht të ekuilibruar, por me një dominim të lehtë të zonave urbane. Prishtina ka përqindjen më të lartë të popullsisë urbane me 52.57%, e ndjekur nga Fushë Kosova me 55.89%. Nga ana tjetër, Drenasi dhe Graçanica kanë një shpërndarje më të balancuar, me përkatësisht 48.41% dhe 56.79% të popullsisë që jetojnë në zonat urbane. Ky raport është një tregues i rëndësishëm për prioritetet e menaxhimit dhe planifikimit të shërbimeve për konsumatorë.

Tabela 2. Zona e Shërbimit

Qytet	Urban	Rural	Totali
Prishtinë	1034	933	1967
	52.57%	47.43%	55.91%
Fushë Kosovë	337	266	603
	55.89%	44.11%	17.14%
Podujevë	139	122	261
	53.26%	46.74%	7.42%
Obiliq	75	54	129
	58.14%	41.86%	3.67%
Shtime	40	40	80
	50.00%	50.00%	2.27%
Drenas	61	65	126
	48.41%	51.59%	3.58%
Graçanicë	46	35	81
	56.79%	43.21%	2.30%
Lipjan	176	95	271
	9.22%	5.90%	7.70%
<b>Total</b>	<b>1908</b>	<b>1610</b>	<b>3518</b>
	<b>54.24%</b>	<b>45.76%</b>	<b>100%</b>

Figura 2. Zona e Shërbimit




## 4.2. Gjinia

Rezultatet e hulumtimit tregojnë se femrat përbëjnë shumicën e të anketuarve me 60.03%, ndërsa meshkujt përfaqësojnë 39.97% të totalit. Ky trend është i pranishëm në të gjitha komunat, veçanërisht në Shtime me 77.50% dhe Podujevë me 73.18%, ndërsa balanca më e afërt midis gjinive vërehet në Graçanicë, ku femrat përfaqësojnë 53.09% dhe meshkujt 46.91%.

Tabela 3. Gjinia

Qytet	Femër	Mashkull	Totali
Prishtinë	1177	790	1967
	59.84%	40.16%	55.91%
Fushë Kosovë	371	232	603
	61.53%	38.47%	17.14%
Podujevë	191	70	261
	73.18%	26.82%	7.42%
Obiliq	82	47	129
	63.57%	36.43%	3.67%
Shtime	62	18	80
	77.50%	22.50%	2.27%
Drenas	72	54	126
	57.14%	42.86%	3.58%
Graçanicë	43	38	81
	53.09%	46.91%	2.30%
Lipjan	114	157	271
	5.40%	11.17%	7.70%
Total	2112	1406	3518
	60.03%	39.97%	100%

Figura 3. Gjinia



### 4.3. Kënaqshmëria me furnizimin me ujë të pijshëm

Analiza e kënaqshmërisë së konsumatorëve të kategorisë së amvisërisë tregon një nivel të lartë të kënaqësisë me furnizimin me ujë të pijshëm. Rezultatet tregojnë se 74.45% e të anketuarve janë shumë të kënaqur, ndërsa 19.22% janë të kënaqur, duke sugjeruar se shumica dërrmuese e konsumatorëve e vlerësojnë pozitivisht cilësinë dhe stabilitetin e furnizimit me ujë. Përqindja e atyre që mbeten neutrale është relativisht e ulët, me 4.49%, ndërsa pakënaqësia mbetet minimale, ku vetëm 1.39% janë të pakënaqur dhe 0.45% shumë të pakënaqur. Nga një analizë më e detajuar sipas komunave, Prishtina dhe Fushë Kosova shfaqin nivelin më të lartë të kënaqshmërisë, përkatësisht me 79.41% dhe 76.78% të anketuarve që janë shumë të kënaqur. Ky rezultat mund të lidhet me infrastrukturën më të zhvilluar dhe cilësinë më të lartë të shërbimeve në këto zona urbane. Në të kundërt, Drenasi dhe Graçanica shfaqin përqindje më të ulëta të kënaqshmërisë, me një numër më të lartë të përgjigjeve neutrale dhe të pakënaqura. Në Drenas, 42.86% e të anketuarve janë të kënaqur, por një përqindje e konsiderueshme prej 14.29% mbetet neutrale. Ndërkohë, në Graçanicë vetëm 38.27% e të anketuarve shprehen shumë të kënaqur, ndërsa një përqindje e lartë prej 30.86% mbetet neutrale, duke treguar një perceptim më të paqartë ose një eksperiencë të ndryshme me furnizimin me ujë në këtë zonë.

Tabela 4. Kënaqshmëria me furnizimin me ujë të pijshëm

Qytet	Shumë të kënaqur (5)	I/e kënaqur (4)	Neutral / Mesatar (3)	I/e pakënaqur (2)	Shumë i/e pakënaqur (1)	Totali
Prishtinë	1,562	352	48	0	5	1,967
	79.41%	17.90%	2.44%	0.00%	0.25%	55.91%
Fushë Kosovë	463	110	7	23	0	603
	76.78%	18.24%	1.16%	3.81%	0.00%	17.14%
Podujevë	210	29	11	6	5	261
	80.46%	11.11%	4.21%	2.30%	1.92%	7.42%
Obiliq	125	2	2	0	0	129
	96.90%	1.55%	1.55%	0.00%	0.00%	3.67%
Shtime	79	1	0	0	0	80
	98.75%	1.25%	0.00%	0.00%	0.00%	2.27%
Drenas	42	54	18	11	1	126
	33.33%	42.86%	14.29%	8.73%	0.79%	3.58%
Graçanicë	31	25	25	0	0	81
	38.27%	30.86%	30.86%	0.00%	0.00%	2.30%
Lipjan	107	103	47	9	5	271
	39.48%	38.01%	17.34%	3.32%	1.85%	7.70%
Total	2,619	676	158	49	16	3,518
	74.45%	19.22%	4.49%	1.39%	0.45%	100%


#### 4.4. Përvoja me defektet teknike (Ujë ose kanalizim)

Të dhënat më poshtë tregojnë se shumica dërrmuese e të anketuarve, 90.88%, nuk kanë pasur përvoja me defekte teknike në ujësjellës ose kanalizim, ndërsa vetëm 9.12% kanë raportuar probleme. Prishtina, si komuna më e madhe, regjistron numrin më të lartë të rasteve të raportuara, me 117 raste, megjithëse kjo përfaqëson vetëm 5.95% të të anketuarve në këtë zonë. Nga ana tjetër, komunat me përqindjen më të lartë të raportimeve janë Drenasi me 41.27% dhe Graçanica me 38.27%, duke treguar një përqendrim më të madh të sfidave teknike në këto rajone. Në kontrast, Fushë Kosova dhe Shtime shfaqin përqindjen më të ulët të problemeve të raportuara, me përkatësisht 1.66% dhe 1.25%. Këto rezultate tregojnë se, ndonëse shumica e konsumatorëve nuk përjetojnë ndërprerje apo probleme të theksuara me shërbimin, disa zona përballen me sfida më të shpeshta në infrastrukturën e ujësjellësit dhe kanalizimit.

Tabela 5. Përvoja me defektet teknike (Ujë ose kanalizim)

Qytet	Po	Jo	Totali
Prishtinë	117	1850	1967
	5.95%	94.05%	55.91%
Fushë Kosovë	10	593	603
	1.66%	98.34%	17.14%
Podujevë	23	238	261
	8.81%	91.19%	7.42%
Obiliq	3	126	129
	2.33%	97.67%	3.67%
Shtime	1	79	80
	1.25%	98.75%	2.27%
Drenas	52	74	126
	41.27%	58.73%	3.58%
Graçanicë	31	50	81
	38.27%	61.73%	2.30%
Lipjan	84	187	271
	26.17%	5.85%	7.70%
Total	321	3197	3518
	9.12%	90.88%	100%

Figura 4. Përvoja me defektet teknike (Ujë ose kanalizim)



#### 4.5. Kënaqshmëria me reagimin dhe efikasitetin e K.R.U. "Prishtina" Sh.A. në rregullimin e defekteve

Sa i përket pyetjes mbi kënaqshmërinë me kohën e reagimit dhe efikasitetin e ndërhyrjeve të K.R.U. "Prishtina" Sh.A. shumica e konsumatorëve kanë shprehur vlerësim pozitiv, ku 30.53% janë shumë të kënaqur dhe 29.91% të kënaqur. Prishtina shfaq nivelin më të lartë të kënaqshmërisë, me 86.32% të përgjigjeve pozitive, ndërsa Drenasi dhe Graçanica regjistrojnë përqindjet më të larta të pakënaqësisë, përkatësisht 11.54% dhe 12.90%. Përqindja e lartë e përgjigjeve neutrale në disa komuna sugjeron një mungesë informacioni ose përvoja të paqarta në lidhje me shërbimin. Këto rezultate pasqyrojnë një performancë të përgjithshme pozitive të shërbimeve teknike, por gjithashtu nënvizojnë nevojën për përmirësime në disa zona për të reduktuar pakënaqësinë dhe për të rritur ndërgjegjësimin mbi shërbimet e mirëmbajtjes.

Tabela 6. Kënaqshmëria me reagimin dhe efikasitetin e K.R.U. "Prishtina" Sh.A. në rregullimin e defekteve

Qytet	Shumë të kënaqur (5)	I/e kënaqur (4)	Neutral / Mesatar (3)	I/e pakënaqur (2)	Shumë i/e pakënaqur (1)	Totali
Prishtinë	64	37	15	1	0	117
	54.70%	31.62%	12.82%	0.85%	0.00%	36.45%
Fushë Kosovë	2	0	5	3	0	10
	20.00%	0.00%	50.00%	30.00%	0.00%	3.12%
Podujevë	0	21	2	0	0	23
	0.00%	91.30%	8.70%	0.00%	0.00%	7.17%
Obiliq	0	1	0	2	0	3
	0.00%	33.33%	0.00%	66.67%	0.00%	0.93%
Shtime	0	1	0	0	0	1
	0.00%	100%	0.00%	0.00%	0.00%	0.31%
Drenas	8	9	29	6	0	52
	15.38%	17.31%	55.77%	11.54%	0.00%	16.20%
Graçanicë	10	3	14	4	0	31
	32.26%	9.68%	45.16%	12.90%	0.00%	9.66%
Lipjan	14	24	42	3	1	84
	16.67%	28.57%	50.00%	3.57%	1.19%	26.17%
Total	98	96	107	19	1	321
	30.53%	29.91%	33.33%	5.92%	0.31%	100%

#### 4.6. Vlerësimi për mirësjelljen dhe qasjen e stafit të K.R.U. "Prishtina" Sh.A.

Në bazë të hulumtimit mbi këtë pyetje, të dhënat pasqyrojnë një nivel të lartë të kënaqshmërisë me qasjen dhe mirësjelljen e stafit të K.R.U. "Prishtina" Sh.A. Sipas rezultateve, 67.23% e të anketuarve janë shumë të kënaqur, ndërsa 22.83% janë të kënaqur. Prishtina dhe Obiliqi shfaqin përqindjet më të larta të kënaqësisë, përkatësisht 70.01% dhe 96.90%. Nga ana tjetër, Graçanica dhe Lipjani kanë përqindje më të larta të përgjigjeve neutrale dhe të pakënaqura, duke sugjeruar një nevojë për përmirësim të qasjes ndaj klientëve në këto zona. Me një nivel të ulët të pakënaqësisë, vetëm 1.67% në total, rezultatet konfirmojnë një performancë pozitive të stafit të K.R.U. "Prishtina" Sh.A., por gjithashtu tregojnë mundësi për përmirësime në disa komuna.

Tabela 7. Vlerësimi për mirësjelljen dhe qasjen e stafit të K.R.U. "Prishtina" Sh.A.

Qytet	Shumë të kënaqur(5)	I/e kënaqur (4)	Neutral / Mesatar (3)	I/e pakënaqur (2)	Shumë i/e pakënaqur (1)	Totali
Prishtinë	1,377	469	113	4	4	1,967
	70.01%	23.84%	5.74%	0.20%	0.20%	55.91%
Fushë Kosovë	399	141	41	22	0	603
	66.17%	23.38%	6.80%	3.65%	0.00%	17.14%
Podujevë	212	30	7	9	3	261
	81.23%	11.49%	2.68%	3.45%	1.15%	7.42%
Obiliq	125	2	2	0	0	129
	96.90%	1.55%	1.55%	0.00%	0.00%	3.67%
Shtime	79	1	0	0	0	80
	98.75%	1.25%	0.00%	0.00%	0.00%	2.27%
Drenas	45	49	28	4	0	126
	35.71%	38.89%	22.22%	3.17%	0.00%	3.58%
Graçanicë	22	18	36	5	0	81
	27.16%	22.22%	44.44%	6.17%	0.00%	2.30%
Lipjan	106	93	64	4	4	271
	39.11%	34.32%	23.62%	1.48%	1.48%	7.70%
Total	2,365	803	291	48	11	3,518
	67.23%	22.83%	8.27%	1.36%	0.31%	100%



#### 4.7. Kënaqshmëria mbi efikasitetin e stafit të KRU-së në leximin e ujëmatësve dhe faturimin

Të dhënat e këtij hulumtimi pasqyrojnë perceptimin e konsumatorëve mbi efikasitetin e stafit të K.R.U.-së në procesin e leximit të ujëmatësve, përgatitjen e faturave dhe pasqyrimin e pagesave. Rezultatet tregojnë një shkallë të lartë të kënaqësisë, ku 64.72% e të anketuarve janë shumë të kënaqur dhe 22.37% të kënaqur, duke reflektuar një performancë pozitive të këtyre shërbimeve. Prishtina dhe Obiliqi shfaqin nivelin më të lartë të kënaqësisë, me përkatësisht 66.95% dhe 97.67% të anketuarve që shprehen shumë të kënaqur. Ndërkohë, Graçanica dhe Lipjani kanë përqindje më të larta të përgjigjeve neutrale dhe të pakënaqura, duke sugjeruar nevojën për përmirësim të këtyre shërbimeve në këto zona. Megjithëse përqindja e përgjithshme e pakënaqësisë është e ulët, me vetëm 1.51%, në disa komuna si Graçanica (8.64%) dhe Lipjani (3.32%) kjo përqindje është më e lartë, duke treguar sfida specifike. Këto rezultate tregojnë se, ndonëse shërbimet e faturimit dhe leximit të ujëmatësve funksionojnë mirë në shumicën e komunave, ka ende hapësirë për përmirësim në zonat ku konsumatorët kanë shprehur më shumë pasiguri ose pakënaqësi.

Tabela 8. Kënaqshmëria mbi efikasitetin e stafit të KRU-së në leximin e ujëmatësve dhe faturimin

Qytet	Shumë të kënaqur (5)	I/e kënaqur (4)	Neutral / Mesatar (3)	I/e pakënaqur (2)	Shumë i/e pakënaqur (1)	Totali
Prishtinë	1,317	490	155	5	0	1,967
	66.95%	24.91%	7.88%	0.25%	0.00%	55.91%
Fushë Kosovë	426	54	102	21	0	603
	70.65%	8.96%	16.92%	3.48%	0.00%	17.14%
Podujevë	209	36	5	9	2	261
	80.08%	13.79%	1.92%	3.45%	0.77%	7.42%
Obiliq	126	0	3	0	0	129
	97.67%	0.00%	2.33%	0.00%	0.00%	3.67%
Shtime	76	4	0	0	0	80
	95.00%	5.00%	0.00%	0.00%	0.00%	2.27%
Drenas	43	47	34	2	0	126
	34.13%	37.30%	26.98%	1.59%	0.00%	3.58%
Graçanicë	18	19	37	7	0	81
	22.22%	23.46%	45.68%	8.64%	0.00%	2.30%
Lipjan	62	137	62	9	1	271
	22.88%	50.55%	22.88%	3.32%	0.37%	7.70%
Total	2,277	787	398	53	3	3,518
	64.72%	22.37%	11.31%	1.51%	0.09%	100%

#### 4.8. Kënaqshmëria për mundësitë e pagesës së shërbimeve

Rezultatet e hulumtimit tregojnë një nivel të lartë të kënaqësisë së konsumatorëve me opsionet e pagesës që ofron kompania për shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit. Sipas të dhënave, 73.37% e të anketuarve janë shumë të kënaqur dhe 15.52% të kënaqur, duke sugjeruar se shumica e qytetarëve e vlerësojnë fleksibilitetin dhe qasjen e lehtë ndaj metodave të pagesës. Megjithatë, disa komuna shfaqin përqindje më të larta të përgjigjeve neutrale dhe të pakënaqura, duke treguar se ende ka sfida për t'u adresuar. Lipjani ka një përqindje të konsiderueshme të konsumatorëve të pakënaqur 13.55%, ndërsa Drenasi ka një nivel të lartë neutraliteti 24.60%, çka mund të sugjerojë mungesë informacioni ose vështirësi në përdorimin e disa metodave të pagesës. Në përgjithësi, rezultatet reflektojnë një performancë të mirë të shërbimeve të pagesës, por gjithashtu nënvizojnë nevojën për përmirësim në disa zona. Rritja e ndërgjegjësimit mbi opsionet e ndryshme të pagesës dhe zgjerimi i mundësive të aksesit në disa komuna mund të ndihmojnë në uljen e pakënaqësisë dhe në rritjen e kënaqësisë së përgjithshme të konsumatorëve.

Tabela 9. Kënaqshmëria për mundësitë e pagesës së shërbimeve

Qytet	Shumë të kënaqur (5)	I/e kënaqur (4)	Neutral / Mesatar (3)	I/e pakënaqur (2)	Shumë i/e pakënaqur (1)	Totali
Prishtinë	1,604	224	134	5	0	1,967
	81.55%	11.39%	6.81%	0.25%	0.00%	55.91%
Fushë Kosovë	477	68	37	21	0	603
	79.10%	11.28%	6.14%	3.48%	0.00%	17.14%
Podujevë	185	49	7	9	11	261
	70.88%	18.77%	2.68%	3.45%	4.21%	7.42%
Obiliq	123	4	2	0	0	129
	95.35%	3.10%	1.55%	0.00%	0.00%	3.67%
Shtime	77	3	0	0	0	80
	96.25%	3.75%	0.00%	0.00%	0.00%	2.27%
Drenas	40	47	31	8	0	126
	31.75%	37.30%	24.60%	6.35%	0.00%	3.58%
Graçanicë	20	29	32	0	0	81
	24.69%	35.80%	39.51%	0.00%	0.00%	2.30%
Lipjan	55	122	56	37	1	271
	20.30%	45.02%	20.66%	13.65%	0.37%	7.70%
Total	<b>2,581</b>	<b>546</b>	<b>299</b>	<b>80</b>	<b>12</b>	<b>3,518</b>
	<b>73.37%</b>	<b>15.52%</b>	<b>8.50%</b>	<b>2.27%</b>	<b>0.34%</b>	<b>100%</b>

#### 4.9. Kënaqshmëria mbi informimin nga Qendra e thirrjeve në lidhje me shërbimet teknike të kryera

Niveli i informimit që konsumatorët marrin nga kompania për shërbimet teknike të kryera është përgjithësisht pozitiv, me 54.01% të anketuarve që janë shumë të kënaqur dhe 16.46% të kënaqur. Kjo tregon se shumica e konsumatorëve ndihen të informuar për ndërhyrjet teknike dhe shërbimet e mirëmbajtjes. Megjithatë, 19.81% e të anketuarve janë neutralë, çka sugjeron se një pjesë e konsiderueshme e konsumatorëve mund të mos kenë marrë informacion të mjaftueshëm ose nuk e kanë vlerësuar atë si të rëndësishëm. Përqindja e pakënaqësisë mbetet e ulët në total, me 8.44%, por në disa komuna si Lipjani 21.40% dhe Graçanica 16.05% është dukshëm më e lartë, duke treguar mungesë efektive të komunikimit në këto zona. Këto rezultate nënvizojnë rëndësinë e përmirësimit të mekanizmave të informimit për të siguruar që të gjithë konsumatorët të kenë qasje të barabartë dhe të mjaftueshme në informacion mbi shërbimet teknike të ofruara.

Tabela 10. Kënaqshmëria mbi informimin nga Qendra e thirrjeve në lidhje me shërbimet teknike të kryera

Qytet	Shumë të kënaqur (5)	I/e kënaqur (4)	Neutral / Mesatar (3)	I/e pakënaqur (2)	Shumë i/e pakënaqur (1)	Totali
Prishtinë	1,013	288	440	190	36	1,967
	51.50%	14.64%	22.37%	9.66%	1.83%	55.91%
Fushë Kosovë	382	67	131	23	0	603
	63.35%	11.11%	21.72%	3.81%	0.00%	17.14%
Podujevë	187	37	28	5	4	261
	71.65%	14.18%	10.73%	1.92%	1.53%	7.42%
Obiliq	123	3	2	1	0	129
	95.35%	2.33%	1.55%	0.78%	0.00%	3.67%
Shtime	79	1	0	0	0	80
	98.75%	1.25%	0.00%	0.00%	0.00%	2.27%
Drenas	39	58	19	10	0	126
	30.95%	46.03%	15.08%	7.94%	0.00%	3.58%
Graçanicë	32	16	20	10	3	81
	39.51%	19.75%	24.69%	12.35%	3.70%	2.30%
Lipjan	45	109	57	58	2	271
	16.61%	40.22%	21.03%	21.40%	0.74%	7.70%
Total	1,900	579	697	297	45	3,518
	54.01%	16.46%	19.81%	8.44%	1.28%	100%


#### 4.10. Pagesa e faturave

Të dhënat e paraqitura në tabelë dhe grafikun përkatës tregojnë se shumica e konsumatorëve, 51.29%, i paguajnë faturat e ujësjellësit dhe kanalizimit "kohë pas kohe", ndërsa 46.73% i paguajnë rregullisht. Përqindja e atyre që nuk i paguajnë fare faturat mbetet e ulët, me vetëm 1.82%, por në disa komuna ky numër është më i lartë. Në Podujevë, 11.49% e të anketuarve deklarojnë se nuk e kanë kryer këtë obligim. Prishtina ka numrin më të lartë të konsumatorëve që paguajnë "kohë pas kohe", ndërsa Obiliqi regjistron përqindjen më të lartë të pagesave të rregullta, me 99.22%. Këto të dhëna ofrojnë një pasqyrë të qartë mbi sjelljen e konsumatorëve në raport me detyrimet e pagesës, duke reflektuar faktorë të ndryshëm ekonomikë dhe socialë në komuna të ndryshme.

Tabela 11. Pagesa e faturave

Qytet	Rregullisht	Kohë pas kohe	Asnjëherë	Totali
Prishtinë	583	1,351	33	1,967
	29.64%	68.68%	1.68%	55.91%
Fushë Kosovë	414	188	1	603
	68.66%	31.18%	0.17%	17.14%
Podujevë	181	50	30	261
	69.35%	19.16%	11.49%	7.42%
Obiliq	128	1	0	129
	99.22%	0.78%	0.00%	3.67%
Shtime	80	0	0	80
	100%	0.00%	0.00%	2.27%
Drenas	81	45	0	126
	64.29%	35.71%	0.00%	3.58%
Graçanicë	38	43	0	81
	46.91%	53.09%	0.00%	2.30%
Lipjan	139	132	0	271
	51.29%	48.71%	0.00%	7.70%
Total	1,644	1,810	64	3,518
	46.73%	51.45%	1.82%	100%

Figura 5. Pagesa e faturave



#### 4.11. Arsyeya e mos pagesës së faturave

Të dhënat e paraqitura më poshtë janë bazuar vetëm në përgjigjet e 64 konsumatorëve të cilët kanë deklaruar në pikën 4.10 se nuk e kanë kryer asnjëherë pagesën e faturave. Në bazë të rezultateve të anketimit, gjendja sociale është arsyeja e vetme e mos pagesës së faturave, e raportuar në 100% të rasteve. Ky fenomen është më i theksuar në Prishtinë dhe Podujevë, ndërsa në komunat e tjera nuk janë identifikuar raste të mos pagesës. Pakënaqësia me shërbimin dhe mospranimi i faturës nuk janë përmendur si faktorë që ndikojnë në mos pagesën, duke treguar se sfidat ekonomike janë arsyeja kryesore që ndikon në këtë aspekt. Duke pasur parasysh këtë situatë, K.R.U. "Prishtina" Sh.A. mund të shqyrtojë masa lehtësuese për konsumatorët që përballen me vështirësi financiare, me qëllim përmirësimin e pagesave dhe mbështetjen e grupeve më të prekura.

Tabela 12. Arsyeya e mos pagesës së faturave

Qytet	Gjendja sociale	Pakënaqësia me shërbimin e pranuar	Mospranimi i faturës	Totali
Prishtinë	33	0	0	33
	100%	0.00%	0.00%	51.56%
Fushë Kosovë	1	0	0	1
	100%	0.00%	0.00%	1.56%
Podujevë	30	0	0	30
	100%	0.00%	0.00%	46.88%
Obiliq	0	0	0	0
	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%
Shtime	0	0	0	0
	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%
Drenas	0	0	0	0
	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%
Graçanicë	0	0	0	0
	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%
Lipjan	0	0	0	0
	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%
Total	64	0	0	64
	100%	0.00%	0.00%	100%


#### 4.12. Preferenca për metodat e pagesës

Të dhënat në vijim janë analizuar vetëm për 3,454 konsumatorë që në pikën 4.10 kanë deklaruar se i paguajnë faturat rregullisht ose kohë pas kohe. Rezultatet e paraqitura në tabelë dhe grafikun përkatës tregojnë se metoda më e preferuar e pagesës nga konsumatorët është përmes sporteleve ose pikave të arkëtimit të K.R.U. "Prishtina" Sh.A., me 60.68% të të anketuarve që zgjedhin këtë opsion. Kjo preferencë është veçanërisht e theksuar në Fushë Kosovë 73.26% dhe Prishtinë 59.93%, duke sugjeruar se shumica e konsumatorëve ende preferojnë pagesën fizike. Agjensionet për transfer parash, si Posta e Kosovës, Capital dhe Moneta, janë opsioni i dytë më i përdorur, duke përfaqësuar 23.07% të totalit, Debitimi direkt përmes bankave dhe pagesa online përmes aplikacionit Ekруп mbeten metoda më pak të përdorura, me përkatësisht 7.99% dhe 8.25%, duke treguar një prani të ulët të shërbimeve digjitale në këtë sektor. Rezultatet sugjerojnë një nevojë për të promovuar më tej përdorimin e metodave elektronike të pagesës.

Tabela 13. Preferenca për metodat e pagesës

Qytet	Sportel/pikë të arkëtimit të KRU	Online përmes platformës apo aplikacionit të telefonit Ekруп	Debitim direkt (përmes bankës)	Agjensionet për transfer parash (Posta e Kosovës, Capital, Moneta, etj.)	Totali
Prishtinë	1,159	226	160	389	1,934
	59.93%	11.69%	8.27%	20.11%	55.99%
Fushë Kosovë	441	34	37	90	602
	73.26%	5.65%	6.15%	14.95%	17.43%
Podujevë	140	13	16	62	231
	60.61%	5.63%	6.93%	26.84%	6.69%
Obiliq	53	0	0	76	129
	41.09%	0.00%	0.00%	58.91%	3.73%
Shtime	27	0	0	53	80
	33.75%	0.00%	0.00%	66.25%	2.32%
Drenas	74	2	10	40	126
	58.73%	1.59%	7.94%	31.75%	3.65%
Graçanicë	34	9	12	26	81
	41.98%	11.11%	14.81%	32.10%	2.35%
Lipjan	168	1	41	61	271
	61.99%	0.37%	15.13%	22.51%	7.85%
Total	2,096	285	276	797	3,454
	60.68%	8.25%	7.99%	23.07%	100%

Figura 6. Preferenca për metodat e pagesës




#### 4.13. Informimi i Konsumatorëve mbi Aplikacionin e K.R.U. "Prishtina" Sh.A.

Sa i përket informimit të konsumatorëve mbi Aplikimin e K.R.U. "Prishtina" Sh.A., vetëm 30.73% e konsumatorëve janë në dijeni se K.R.U. "Prishtina" Sh.A. ka krijuar një aplikacion mobil për pagesën e faturave, ndërsa shumica ose 69.27% nuk kanë informacion për këtë shërbim. Kjo mungesë ndërgjegjësimi është veçanërisht e lartë në Lipjan 90.60% dhe Shtime 87.50%, ndërsa komunat me informimin më të mirë janë Graçanica 69.14% dhe Fushë Kosova 50.25%. Prishtina, si komuna më e madhe, gjithashtu ka një përqindje të lartë të konsumatorëve që nuk janë në dijeni të aplikacionit 75.04%, duke treguar nevojën për më shumë promovim dhe fushata informuese.

Tabela 14. Informimi i Konsumatorëve mbi Aplikacionin e K.R.U. "Prishtina" Sh.A.

Qytet	Po	Jo	Totali
Prishtinë	491	1476	1967
	24.96%	75.04%	55.91%
Fushë Kosovë	303	300	603
	50.25%	49.75%	17.14%
Podujevë	67	194	261
	25.67%	74.33%	7.42%
Obiliq	54	75	129
	41.86%	58.14%	3.67%
Shtime	10	70	80
	12.50%	87.50%	2.27%
Drenas	58	68	126
	46.03%	53.97%	3.58%
Graçanicë	56	25	81
	69.14%	30.86%	2.30%
Lipjan	42	229	271
	3.89%	9.40%	7.70%
Total	1081	2437	3518
	30.73%	69.27%	100%

Figura 7. Informimi i Konsumatorëve mbi Aplikacionin e K.R.U. "Prishtina" Sh.A.






#### 4.14. Përdorimi i aplikacionit K.R.U. "Prishtina" Sh.A.

Të dhënat në vijim janë bazuar vetëm në 1081 konsumatorë që në pikën 4.13 janë përgjigjur Po se janë në dijeni për ekzistencën e aplikacionit të K.R.U. "Prishtina" Sh.A. për pagesën e faturave. Përdorimi i aplikacionit të K.R.U. "Prishtina" Sh.A. varion ndjeshëm midis komunave, duke treguar një nivel të ndryshëm të adaptimit të shërbimeve digjitale nga konsumatorët. Në total, 64.75% e të anketuarve që janë në dijeni për aplikacionin e përdorin atë, ndërsa 35.25% ende nuk e kanë integruar në praktikat e tyre. Prishtina ka numrin më të lartë të përdoruesve aktivë 80.86%, e ndjekur nga Obiliqi 92.59% dhe Drenasi 89.66%, duke treguar një nivel të lartë të pranimit të teknologjisë në këto komuna. Nga ana tjetër, komunat me përdorimin më të ulët të aplikacionit janë Shtime 10.00% dhe Lipjani 3.86%, çka sugjeron një mungesë ndërgjegjësimi ose qasje më të kufizuara në shërbimet digjitale.

Tabela 15. Përdorimi i aplikacionit K.R.U. "Prishtina" Sh.A.

Qytet	Po	Jo	Totali
Prishtinë	397	94	491
	80.86%	19.14%	45.42%
Fushë Kosovë	111	192	303
	36.63%	63.37%	28.03%
Podujevë	20	47	67
	29.85%	70.15%	6.20%
Obiliq	50	4	54
	92.59%	7.41%	5.00%
Shtime	1	9	10
	10.00%	90.00%	0.93%
Drenas	52	6	58
	89.66%	10.34%	5.37%
Graçanicë	42	14	56
	75.00%	25.00%	5.18%
Lipjan	27	15	42
	3.86%	3.94%	3.89%
Total	700	381	1081
	64.75%	35.25%	100%

Figura 8. Përdorimi i aplikacionit K.R.U. "Prishtina" Sh.A.



#### 4.15. Kënaqshmëria me Përdorimin e Aplikacionit të K.R.U. "Prishtina" Sh.A."

Të dhënat e mëposhtme janë bazuar vetëm në 700 konsumatorë që në pikën 4.14 janë përgjigjur "Po", pra që deklaruan se e përdorin aplikacionin e K.R.U. "Prishtina" Sh.A. për pagesën e faturave. Vlerësimi i kënaqshmërisë me përdorimin e aplikacionit të K.R.U. "Prishtina" Sh.A. tregon një nivel të lartë të pranimit pozitiv nga konsumatorët, ku 82.00% janë "shumë të kënaqur" dhe 13.00% "të kënaqur". Prishtina dhe Fushë Kosova kanë përqindjet më të larta të kënaqësisë, me mbi 86% të përdoruesve që e vlerësojnë aplikacionin pozitivisht. Nga ana tjetër, disa komuna si Podujeva dhe Graçanica shfaqin një përqindje më të lartë të përgjigjeve neutrale dhe të pakënaqura, duke sugjeruar hapësirë për përmirësime të mëtejshme. Përqindja e atyre që shprehen "shumë të pakënaqur" është minimale 0.43%, duke treguar se aplikacioni në përgjithësi ka një ndikim pozitiv te konsumatorët, por mund të kërkojë optimizime për ta bërë më të përshtatshëm për të gjitha grupet e përdoruesve.

Tabela 16. Kënaqshmëria me Përdorimin e Aplikacionit të K.R.U. "Prishtina" Sh.A."

Qytet	Shumë të kënaqur (5)	I/e kënaqur (4)	Neutral / Mesatar (3)	I/e pakënaqur (2)	Shumë i/e pakënaqur (1)	Totali
Prishtinë	344	33	20	0	0	397
	86.65%	8.31%	5.04%	0.00%	0.00%	56.71%
Fushë Kosovë	111	0	0	0	0	111
	100%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	15.86%
Podujevë	3	3	3	8	3	20
	15.00%	15.00%	15.00%	40.00%	15.00%	2.86%
Obiliq	50	0	0	0	0	50
	100%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	7.14%
Shtime	1	0	0	0	0	1
	100%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.14%
Drenas	40	12	0	0	0	52
	76.92%	23.08%	0.00%	0.00%	0.00%	7.43%
Graçanicë	12	29	1	0	0	42
	28.57%	69.05%	2.38%	0.00%	0.00%	6.00%
Lipjan	13	14	0	0	0	27
	48.15%	51.85%	0.00%	0.00%	0.00%	3.86%
Total	574	91	24	8	3	700
	82.00%	13.00%	3.43%	1.14%	0.43%	100%


#### 4.16. Si informohen konsumatorët për defektet dhe ndërprerjet e ujit

Mënyra se si konsumatorët informohen për defektet dhe ndërprerjet e ujit tregon një dominim të rrjeteve sociale, me 53.50% të të anketuarve që marrin njoftime përmes rrjeteve sociale. Prishtina dhe Obiliqi kanë përqindjen më të lartë të përdoruesve që informohen përmes këtyre platformave, ndërsa televizionet lokale 13.05% dhe radiot 21.26% mbeten burime dytësore. Pavarësisht kësaj, 12.19% e konsumatorëve nuk marrin fare njoftime, veçanërisht në Lipjan 18.08%, duke sugjeruar nevojën për një komunikim më efektiv. K.R.U. "Prishtina" Sh.A. mund të balancojë përdorimin e kanaleve tradicionale dhe digjitale për të siguruar që çdo konsumator të jetë i informuar mbi ndërprerjet e ujit.

Tabela 17. Si informohen konsumatorët për defektet dhe ndërprerjet e ujit

Qytet	Njoftohem përmes TV lokale	Njoftohem përmes Radios	Njoftohem përmes rrjeteve sociale (Facebook, Instagram)	Nuk njoftohem fare	Totali
Prishtinë	262	440	994	271	1,967
	13.32%	22.37%	50.53%	13.78%	55.91%
Fushë Kosovë	77	157	289	80	603
	12.77%	26.04%	47.93%	13.27%	17.14%
Podujevë	25	50	168	18	261
	9.58%	19.16%	64.37%	6.90%	7.42%
Obiliq	2	1	126	2	131
	1.53%	0.76%	96.18%	1.53%	3.72%
Shtime	0	1	77	0	78
	0.00%	1.28%	98.72%	0.00%	2.22%
Drenas	33	21	71	1	126
	26.19%	16.67%	56.35%	0.79%	3.58%
Graçanicë	7	16	50	8	81
	8.64%	19.75%	61.73%	9.88%	2.30%
Lipjan	53	62	107	49	271
	19.56%	22.88%	39.48%	18.08%	7.70%
Total	459	748	1,882	429	3,518
	13.05%	21.26%	53.50%	12.19%	100%

Figura 9. Si informohen konsumatorët për defektet dhe ndërprerjet e ujit




#### 4.17. Sa janë të informuar konsumatorët për opsionet e shlyerjes së borxhit

Niveli i informimit të konsumatorëve për opsionet e shlyerjes së borxhit tregon dallime të theksuara midis komunave. 38.60% e të anketuarve raportojnë se janë të informuar, ndërsa 61.40% nuk kanë informacion mbi këto opsione. Shtime 100%, Podujeva 99.23 dhe Obiliqi 98.45% janë komunat me përqindjen më të lartë të konsumatorëve të informuar, ndërsa Lipjani 3.17%, Prishtina 27.81% dhe Fushë Kosova 32.67% kanë përqindjet më të ulëta.

Tabela 18. Sa janë të informuar konsumatorët për opsionet e shlyerjes së borxhit

Qytet	Po	Jo	Totali
Prishtinë	547	1420	1967
	27.81%	72.19%	55.91%
Fushë Kosovë	197	406	603
	32.67%	67.33%	17.14%
Podujevë	259	2	261
	99.23%	0.77%	7.42%
Obiliq	127	2	129
	98.45%	1.55%	3.67%
Shtime	80	0	80
	100%	0.00%	2.27%
Drenas	66	60	126
	52.38%	47.62%	3.58%
Gračanicë	39	42	81
	48.15%	51.85%	2.30%
Lipjan	43	228	271
	3.17%	10.56%	7.70%
Total	1358	2160	3518
	38.60%	61.40%	100%

Figura 10. Sa janë të informuar konsumatorët për opsionet e shlyerjes së borxhit




#### 4.18. Vlerësimi i konsumatorëve për mundësinë e riprogramimit të borxhit

Vlerësimi i konsumatorëve për mundësinë e riprogramimit të borxhit tregon një qëndrim kryesisht pozitiv, me 79.82% që e konsiderojnë "shumë të favorshme" dhe 20.10% "deri diku të favorshme". Prishtina dhe Fushë Kosova shfaqin nivele të larta të mbështetjes, ndërsa Obiliqi dhe Shtime tregojnë një pranueshmëri pothuajse të plotë me mbi 96% vlerësime pozitive. Përqindja e atyre që e shohin këtë opsion si "të papërdorshëm" ose "shumë të papërdorshëm" është pothuajse zero, duke treguar se lehtësia e pagesës me këste perceptohet si një masë e dobishme. Rezultatet sugjerojnë se ky program është i mirëpritur nga konsumatorët dhe duhet të promovohet më gjerësisht për të lehtësuar shlyerjen borxheve në mënyrë të qëndrueshme.

Tabela 19. Vlerësimi i konsumatorëve për mundësinë e riprogramimit të borxhit

Qytet	Shumë të favorshme	Deri diku të favorshme	Të papëlqyeshme	Shumë të papëlqyeshme	Totali
Prishtinë	426	120	0	1	547
	77.88%	21.94%	0.00%	0.18%	40.28%
Fushë Kosovë	176	21	0	0	197
	89.34%	10.66%	0.00%	0.00%	14.51%
Podujevë	183	76	0	0	259
	70.66%	29.34%	0.00%	0.00%	19.07%
Obiliq	123	4	0	0	127
	96.85%	3.15%	0.00%	0.00%	9.35%
Shtime	77	3	0	0	80
	96.25%	3.75%	0.00%	0.00%	5.89%
Drenas	53	13	0	0	66
	80.30%	19.70%	0.00%	0.00%	4.86%
Graçanicë	24	15	0	0	39
	61.54%	38.46%	0.00%	0.00%	2.87%
Lipjan	22	21	0	0	43
	51.16%	48.84%	0.00%	0.00%	3.17%
Total	1,084	273	0	1	1,358
	79.82%	20.10%	0.00%	0.07%	100%

Figura 11. Vlerësimi i konsumatorëve për mundësinë e riprogramimit të borxhit




#### 4.19. Ankesa për kompaninë K.R.U. "Prishtina" Sh.A.

